

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1483 / 5 Prot.

Vlorë më, 21 . 5 .2025

**VENDIM
Nr. 58, datë 21.05.2025
PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER
SHKENCOR NË "INXHINIERI ARMATIMI", ME PROFIL MINOR NË AVIACION
DHE NAVAL.**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen , rioorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë*" si dhe referuar propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore ardhur me shkresë Nr 270/1, prot, datë 15.05.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.05.2025,


VENDOSI:


1. Të miratojë Rregulloren e Programit të studimit Master Shkencor ne "Inxhinieri Armatimi", me profil minor ne Aviacion dhe Naval sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore si dhe Zëvendësrektori Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AURELA SALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEKANI

1425
15.05.2025

Nr. 220/ Prot.

Vlorë, më 15/05/2025

Lënda: Përcjellje për miratim rregullorja e programit të studimit të Masterit Shkencor në "Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Naval"

REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
PROF. DR. AURELA SALIAJ

Bazuar në shkresën me Nr 270 Prot, Datë 15.05.2025 të Drejtuesit të Njesisë Bazë "Përcjellje për miratim rregullorja e programit të studimit të Masterit Shkencor në "Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Naval".

- Bashkëngjitur shkresa e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

DEKANI

Prof. Asoc. Miftar RAMOSAÇAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE

Nr. 270 Prot

Vlorë 15.1.2025

Lënda: Përcillet për miratim rregullorja e programit të studimit të Masterit Shkencor
"Inxhinieri armatimi, me profil minor në aviacion dhe naval"

Drejtuar: Prof. Asoc. Miftar RAMOSAÇAJ

DEKAN
I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

I nderuar DEKAN,

Bashkangjitur po ju përcjellim për miratim rregulloren e programit të studimit të Masterit Shkencor
"Inxhinieri armatimi, me profil minor në aviacion dhe naval" për të vazhduar më tej procedurat
e miratimit në Senatin Akademik të Universitetit 'Ismail Qemali', Vlorë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I NJËSISË BAZË
Dr. Pëllumb ÇAÇAJ



UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
VLORË TIRANË

Nr. _____ Prot, datë _____.____.2025

Nr. _____ Prot, datë _____.____.2025

RREGULLORE
E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË DYTË
TË STUDIMEVE MASTER SHKENCOR NË
“INXHINIERI ARMATIMI, ME PROFIL MINOR NË AVIACION DHE
NAVALE”

(Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë dhe Akademia e Forcave të Armatosura)

*Miratuar me vendim nr...../....., datë.....2025 të Senatit të Universitetit “Ismael Qemali”
Vlorë dhe vendim nr...../....., datë.....2025 të Senatit të Akademisë së Forcave të
Armatosura*

Neni 4

Synimi dhe objekti i programit

Programi synon të trajnojë studentët në një fushë ndërdisiplinore që përfshin inxhinierinë e armatimit tokësor, ajror dhe detar, duke i pajisur me aftësi të avancuara teknike, kërkimore dhe praktike.

Objektivat formuese të tij janë:

- Formimi profesional i personelit në fushën e sistemeve të armatimit tokësor, ajror dhe detar.
- Integrimi i praktikës dhe teorisë për të ndërtuar aftësi kërkimore dhe zbatimi profesional.
- Rritja e kompetencave teknike në sistemet e kontrollit, sigurisë dhe drejtimit të teknologjive ushtarake.
- Edukimi për etikën dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.
- Nxitja e kërkimit të aplikuar dhe përfshirja në projekte.
- Promovimi i punësimit përmes praktikave profesionale në institucione të sektorëve ushtarakë dhe civilë.
- Angazhimi i stafit akademik për përmbushjen e standardeve të etikës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Neni 5

Institucionet pjesëmarrëse

Programi realizohet në bashkëpunim ndërinstitucional ndërmjet:

- Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë – përmes Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike.
- Akademisë së Forcave të Armatosura – si institucion bashkë-hartues dhe zbatues i programit nëpërmjet Departamentit të Inovacionit të Institutit Kërkimor Shkencor Ushtarak.

Neni 6

Format dhe organizimi i studimit

Programi i studimit përbëhet nga një seri aktivitete formuese që ndahen në formatet e mëposhtme:

- **Mësim në auditor** - (leksione, seminare dhe laboratorë).
- **Studim individual** - përfshirë studimin e literaturës, përgatitjen e detyrave, projekteve, përgatitjen për provime dhe përgatitjen e tezës së diplomës.
- **Përgatitje dhe mbrojtje e tezës së diplomës** - që është një komponent i rëndësishëm i vlerësimit të përfundimit të programit.
- **Praktikë profesionale** - që është pjesë e detyrueshme e programit dhe zhvillohet në institucione apo ndërmarrje përkatëse.

Neni 7

- Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, lirohen nga detyrimet e frekuentimit sipas rregulloreve të UV-së dhe DITD-së.
- 2. Provimet e dhëna jashtë shtetit për lëndët e ngjashme do të njihen dhe, pas kthimit në UV, studentët duhet të shlyejnë detyrimet për lëndët e tjera.
- 3. Vendimi për njohjen dhe ekuivalentimin e provimeve gjatë mobilitetit ndërkombëtar merret nga komisioni AD-HOC, i ngritur pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, bazuar në Learning Agreement të firmosur përpara mobilitetit.

Neni 10

Ndërprerja e studimeve dhe ripranimi

1. Studentët mund të ndërpresin studimet duke njoftuar paraprakisht Dekanin.
2. Ata mund të rifillojnë studimet pas konsumimit të lejes, në fillim të çdo semestri ose në datën që ata kanë lënë studimet.
3. Studentët që ripranojnë, do t'i nënshtrohen detyrimeve të programit të studimit që ekziston në momentin e rifillimit.
4. Procedurat e ripranimit dhe detaje të tjera janë të parashikuara në rregulloren e Universitetit të Vlorës.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

1. Studentët e regjistruar në programin Master Shkencor në “Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Navale” kanë të njëjtat të drejta siç parashikohet në Rregulloren e UV.
2. Ata gjithashtu kanë të njëjtat detyrime siç parashikohet në Rregulloren e UV-së, duke përfshirë frekuentimin e lëndëve dhe realizimin e detyrimeve përkatëse.

KREU III – FORMAT E KONTROLLIT TË DIJES DHE VLERËSIMI

Neni 12

Format e kontrollit të dijes dhe instrumentet e vlerësimit

1. Programi mësimor Master Shkencor në “Inxhinieri Armatimi, me profile minor në Aviacion dhe Navale” parashikon vlerësime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe të provimit të formimit/temës së diplomës.
2. **Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve (me shkrim, pa përjashtuar edhe atë me gojë), eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomave.**
3. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).

kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit). Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por **minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha lëndët e programit mësimor.** Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.

Neni 15

Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit mund të përfshijnë: **kërkime në fushën përkatëse të armatimit, sistemeve dhe mjeteve ajrore, detare dhe tokësore, projekt kërkimor, punë prezantuese, posterë tematikë.** Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

KREU IV – PROCEDURA DHE RREGULLA TË TJERA AKADEMIKE

Neni 16

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

1. Kontrolli i njohurive bëhet me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave/projekteve të kursit.
2. Pas **48 orëve nga përfundimi** i kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim), pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. **Ky afat mund të zgjatet deri në 72 orë, në rast se pedagogu ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.**
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. Nëse është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, studenti ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. Nëse, pas sqarimit me pedagogun, studenti mbetet i pakënaqur, ai ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit përkatës.
6. Në bazë të kësaj kërkesë, departamenti ngre një **komision apelimi ad hoc**, i cili rivlerëson provimin dhe jep përgjigje brenda **3 ditëve kalendarike** nga paraqitja e kërkesës.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit dhe konsiderohen përfundimtare.

Neni 17

Shkurtime dhe kuptimi i tyre

Për lehtësi në komunikim dhe dokumentacion, në këtë rregullore përdoren shkurtime e mëposhtme:

Detyrimet që lidhen me frekuentimin

1. Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve është i detyrueshëm në masën **75%**.
2. Nëse studenti mungon mbi normën e lejuar, ai **s'kualifikohet për shkak të mungesave**, nuk lejohet të hyjë në provim dhe në procesverbalin e vlerësimit shënohet **"M"** (Mungesë).
3. Në rast se studenti nuk paraqitet në provim, pavarësisht se ka plotësuar frekuentimin, në procesverbalin e vlerësimit shënohet **"NP"** (Nuk u paraqit).
4. Nëse studenti nuk ka detyrim frekuentimi, por nuk paraqitet në asnjë prej provimeve (as i pjesshëm, as finale), vlerësimi përfundimtar pasqyrohet me **"NP"**. Në këtë rast, studenti **nuk mund të regjistrohet për kursin si përsëritës**, por mund ta shlyejë vetëm përmes provimit.
5. Sekretaria mësimore e DITD është përgjegjëse për administrimin e informacionit mbi frekuentimin.

Neni 20

Rregullat e regjistrimit dhe organizimi i kurseve

1. Studentët regjistrohen online përmes **Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Univlora**, sipas planit mësimor të programit.
2. Çdo kurs ka një **kod unik** të përbërë nga tri shkronja që tregojnë disiplinën dhe një numër treshifror identifikues.

Neni 21

Kuotat, tarifat dhe pranimi i studentëve në programin e studimit

1. DITD është përgjegjës për **miratimin e kuotave, tarifave dhe kriterëve të pranimit**, në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura.
2. Tarifa e studimit është **80,000 lekë/vit për student**, me mundësi uljeje, nëse bihet dakord nga të dy institucionet.
3. Pranimi i studentëve bëhet nga një **komision përzgjedhës i përbashkët**, në bazë të kriterëve të miratuara dhe kuotave të shpallura.

Neni 22

Modalitetet për dhënien e diplomës dhe mobiliteti ndërkombëtar

1. Studentët, që marrin pjesë në programe mobiliteti ndërkombëtar (si Erasmus+ apo projekte të tjera), **lirohen nga detyrimet e frekuentimit**, sipas marrëveshjeve përkatëse.
2. Provimet e dhëna gjatë periudhës së mobilitetit për lëndët e ngjashme **njihen nga Universiteti i Vlorës** dhe pas rikthimit, studenti duhet të shlyejë vetëm detyrimet e mbetura.
3. Vendimin për njohjen dhe ekuivalentimin e provimeve e merr një **komision ad hoc** pranë DITD, në bazë të **Learning Agreement**, të firmosur para mobilitetit.

Neni 26
Titulli akademik që jepet

1. Pas përfundimit të programit të studimit dhe mbrojtjes së suksesshme të punimit të diplomës, studenti do të marrë titullin akademik Master Shkencor në “Inxhinieri Armatimi, me profile minor në Aviacion dhe Navale”.
2. Ky titull akademik do të jetë i vlefshëm për të dy fushat përkatëse të studimit (Inxhinieri Armatimi dhe Aviacion/Naval) dhe do të njohë kompetencat e studentit në këto fusha specifike.

Neni 27
Lëshimi i diplomës së përbashkët

1. Diploma e përbashkët për programin Master Shkencor në “Inxhinieri Armatimi, me profile minor në Aviacion dhe Navale” do të lëshohet nga Universiteti i Vlorës në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura, pas përmbushjes së të gjitha kushteve të diplomimit të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Diploma do të përmbajë logot dhe informacionin e të dy institucioneve, si dhe do të përcaktojë titullin akademik që i është dhënë studentit.

KREU VII – KREDITET DHE PRAKTIKAT PROFESIONALE

Neni 28
Kreditet ECTS

1. Në programin e studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Navale”, krediti i formimit i referohet sistemit ECTS, që është Sistemi European i Transferimit të Krediteve. Ky sistem shpreh volumin e punës mësimore që studenti duhet të kryejë për të arritur rezultatet e pritshme të mësimdhënies.
2. Një kredi i përgjigjet 25 (njëzet e pesë) orëve mësimore pune të studentit në këtë program studimi.
3. Sasia vjetore e punës së kryer nga studenti gjatë vitit akademik është 120 (njëqind e njëzet) kredite, ose 3000 (tre mijë) orë mësimore, të cilat përfshijnë orë mësimore në auditor dhe orë pune të pavarur.
4. Kredite për çdo aktivitet formues fitohen vetëm në rast të vlerësimit pozitiv të dijeve të studentit, nëpërmjet verifikimit përfundimtar të rezultateve të tij. Për vlerësimin e dijeve përdoren forma të ndryshme kontrolli, të cilat përfshijnë vlerësimin e vazhdueshëm /semestral dhe atë përfundimtar.

Neni 29
Praktika profesionale

1. Studentët në programin e studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Armatimi, me profil minor në Aviacion dhe Navale” kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale. Me fillimin e semestrit në të cilin parashikohet zhvillimi i praktikës, studentëve u komunikohet koha e kryerjes, programi, mënyra e zhvillimit dhe shlyerja e saj.

- Vendimi i komisionit për ankesën është përfundimtar dhe mund të përfshijë rishikimin e vlerësimeve të provimeve, detyrave ose të vlerësimit të përgjithshëm të kursit.
3. Përveç ankesave për vlerësimin akademik, studentët mund të parashtrojnë kërkesa për ndryshime në orarin e provimeve, regjistrimin në lëndë dhe çdo kërkesë tjetër që ka të bëjë me organizimin akademik.

KREU IX – DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 32

Interpretimi dhe zbatimi i rregullores

1. Çdo çështje që nuk është parashikuar në këtë rregullore do të interpretohet nga Komisioni i Rregullores i caktuar nga departamenti, në përputhje me legjislacionin dhe politikën akademike të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe Akademisë së Forcave të Armatosura.
2. Interpretimi dhe zbatimi i rregullores është në kompetencën e autoriteteve akademike të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe Akademisë së Forcave të Armatosura.

Neni 33

Rishikimi dhe përmirësimi i rregullores

1. Rregullorja e studimeve mund të rishikohet dhe përmirësohet në çdo moment, në përputhje me ndryshimet në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe me zhvillimet e nevojshme akademike dhe teknologjike.
2. Çdo rishikim i rregullores duhet të kalojë nëpërmjet procesit të miratimit nga Senati Akademik i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe i Akademisë së Forcave të Armatosura. Ky proces duhet të jetë i konsultuar me të gjitha palët e interesuara, përfshirë pedagogët dhe studentët.

Neni 34

Hyrja në fuqi


1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Senati Akademik i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe i Akademisë së Forcave të Armatosura. Ajo është e detyrueshme për të gjithë studentët, mësime dhe autoritetet akademike të përfshira në programin Master Shkencor në “Inxhinieri Armatimi, me profile minor në Aviacion dhe Navale”.
2. Çdo ndryshim ose plotësim në këtë rregullore do të shpallet në mënyrë transparente përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe Akademisë së Forcave të Armatosura.

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është edhe *Plani Mësimor dhe Orari i Zhvillimit të Programit*, të cilat miratohen dhe publikohen nga institucionet pjesëmarrëse, në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

B. Programi dhe plani mësimor për studentët e programit të përbashkët të studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Armatimi, me profil minor Naval”, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

Kategoria	Nr.	Kodi	Lënda	Kredite
A	Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (5-10%)	ARM 103	Etikë dhe Ligj Ndërkombëtar në Armatim	6
		ARM 100	Metodologji Kërkimi Shkencor	6
		Totali		12
B	Lëndë Karakterizuese – përgatitje në disiplinën shkencore (50–60%)	ARM 101	Teori e Shpërthimeve, Mekanika e Goditjes, Projektimi i Municioneve dhe Kokat e Luftës	6
		ARM 212	Sistemet e drejtuara luftarake	6
		ARM 104	Sistemet e Armëve dhe Integrimi i tyre	6
		ARM 111	Sistemet e kontrollit automatik	6
		AVI 112	Teknologji të Avancuara të dronëve dhe UAV-ve	6
		NAV 211	Inxhinieria e Aplikimeve Navale në Anijet ushtarake	6
		AVI 200	Sistemet e Navigimit dhe Kontrollit për Raketat	6
		ARM 114	Sensorët dhe vëzhgimi në hapësirën detare	6
		ARM 115	Teknologjia e prototipizimit të shpejtë në sistemet ushtarake	6
		ARM 113	Balistika e Brendshme dhe e Jashtme	6
		ARM 105	Sensorë dhe Teknologji të Ndjeshmërisë për Armatim	6
		Totali		66
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese – Ndërdisiplina, profile dhe grup lëndë me zgjedhje (12–20%)	ARM 102	Thellime në mekanikën e aplikuar	6
		ARM 205	Menaxhimi i Projekteve në Mbrojtje /	6
		ARM 213 (me zgjedhje)	Strategji të Mbrojtjes dhe Roli i Teknologjisë	
		Totali		12
D	Lëndë të tjera mbështetëse (10%)	ARM 215	Praktikë Profesionale në Industrinë e Mbrojtjes	18
	Totali			18
E	Detyrime përmbyllëse (10-15%)	ARM 216	Projekt përfundimtar i Diplomës (Disertacion)	12
Totali				12
Grand Total				120

		ARM 212	Sistemet e mbrojtjes së drejtuar	6	150	75	75	3	2	1	0
		ARM 213	Strategji të Mbrojtjes dhe Roli i Teknologjisë / Menaxhimi i Projekteve në Mbrojtje	6	150	75	75	3	2	1	0
		ARM 202	Metodologji Kërkimi Shkencor	6	150	75	75	3	2	1	0
		ARM 214	Sensorët dhe vëzhgimi në hapësirën detare	6	150	75	75	3	2	1	0
	Totali			30	750	375	375	15	10	5	0
	Sem. IV	ARM 215	Praktikë Profesionale në Industrinë e Mbrojtjes	18	450	225	225	7	1	0	0
		ARM 216	Projekt Final i Diplomës (Disertacion)	12	300	150	150	0	0	0	0
	Totali			12	750	375	375	7	1	0	0
	Grand Total			120	3000	1500	1500	67	41	20	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, 15.5.2025

Drejtuar:
Senatit Akademik

REKTORI

Prof. Dr. Aurela Saliaj

